

Sinjalizime

Ekskluzive | Plagosja në Fushë Kosovë, dyshohet se nipi e qëlloi mixhën pas konfliktit për pronë



Sinjali.com

16 Korrik 2026 08:48



Një konflikt për çështje pronësore brenda një familjeje ka eskaluar në përdorim të armës së zjarrit në Fushë Kosovë, ku një 61-vjeçar mbeti i plagosur, ndërsa i dyshuari është në arrati, raporton Sinjali.

Sinjali raportoi ekskluzivisht se i dyshuari është Fidan Gjyrevci 45 vjeç, ndërsa viktimë mixha i tij, Ibush Gjyrevci rreth 61 vjeç.

Sipas burimeve të Sinjalit, ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e 15 korrikut, rreth orës 20:30, në rrugën “Prizreni”, në fshatin Miradi e Epërme të Fushë Kosovës.

Dyshohet se pas një debati verbal për një kontest pronësor, Fidan Gjyrevci ka nxjerrë një pistoletë dhe ka qëlluar në drejtim të mixhës së tij, duke e plagosur në këmbën e djathtë.

Viktima është transportuar nga familjarët në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ku mjekët kanë konstatuar se kishte një plagë me hyrje dhe dalje të plumbit. Sipas stafit mjekësor, ai ndodhet në gjendje stabile dhe jashtë rrezikut për jetën.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se pas të shtënave, i dyshuari është larguar nga vendi i ngjarjes me një Volkswagen Passat me ngjyrë të zezë. Më vonë, Policia e ka gjetur veturën të braktisur në oborrin e vëllait të tij, por i dyshuari nuk është lokalizuar dhe vazhdon të jetë në arrati.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë hetuesit rajonalë dhe ekipi i forenzikës, të cilët kanë sekuestruar një gëzhgojë të armës së zjarrit si provë materiale.



Lexo edhe

Ekskluzive | Ky është i dyshuari që qëlloi me armë axhën e tii në Miradi të Epërme



Me urdhër të Prokurores së Krimeve të Rënda, rasti është iniciuar si “Vrasje në tentativë”, ndërsa njësitet e hetimeve janë në kërkim të të dyshuarit dhe po vazhdojnë veprimet për zbardhjen e plotë të rastit.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Armë

Axha

Fushë Kosovë

nipi

Plagosje

Të tjera:



Nuk e la ta dërgonte nënën në Greqi, 27-vjeçari dyshohet se rrahu motrën dhe sulm...

Sinjalizime



Ekskluzive | “Do ta paguani me jetë”, kërcënoi punonjësen e Art Motion në Fushë...

Sinjalizime



Një i lënduar nga përplasja e veturës me trenin në Fushë Kosovë

Siguri



Ekskluzive | Zbardhen pesë vjedhje në Fushë Kosovë, arrestohen dy të rinj – pruan se i...

Sinjalizime




Ekskluzive | I vodhën 200 litra naftë nga kamioni në Fushë Kosovë, kamerat...

Sinjalizime



Ky është i riu nga Fushë Kosova që humbi jetën në Shëngjin

Kosovë



Ekskluzive | Borxhet e futën në ferr, i riu tentoi vetëvrasjen me litar – arrestohet i dyshuari p...

Sinjalizime



Paralajmërohet pezullimi i edukatoreve të dyshuara për dhunë ndaj 3-vjeçarit në Fushë...

Arsim

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtimi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukurit dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera